



**Sihana Nexhbija**

**VARGJET E ËNDRRAVE  
TË MIA**

Tetovë, 2020

**S i h a n a N e x h b i j a**

**Vargjet e ëndrrave të mia**

Tetovë

2020

" Nëse e djeshmja të ka kaluar, mes duarve tuaja e ke të sotmen. E nëse edhe e sotmja është duke i mbledhur plaçkat dhe bërë gati për të ikur atëherë do ta kesh të nesërmen. Mos u mërzit për të djeshmen se ajo nuk do të kthehet, e as mos u pendo për të sotmen që është duke të ikur, ëndërro për diellin që do të shkëlqejë në agimin e ndritshëm të së nesërmes ".

I falemenderoj të gjithë ata që më ndihmuan deri në botimin e librit tim të parë me vjersha, e veçanërisht e falemenderoj familjen time të e cila gjeta përkrahje të sinqertë morale e materiale.

Sihana Nexhbija



## **Atdheu**

Atdheun tim shumë e dua,  
Shumë i bukur është për mua,  
Atdheun tim unë e dashuroj,  
Atë e dua dhe e nderoj.

Atdheun tim unë e dashuroj,  
Kur për jetë nuk do ta haroj,  
Atdheun tim do ta kujtoj,  
Tërë jetën do ta mbroj.

## **Bibloteka**

Në bibliotekë  
Marrim libra të lexojmë,  
Dituri të fitojmë,  
Librat nuk duhet grisur  
E dëmtuar,  
Librin duhet lexuar,  
Mësimet për të mësuar,  
Mendjen ta pasurojmë me njohuri.  
Unë kam libra në shtëpi,  
I lexoj me shumë kënaqësi,  
Lexoni libra edhe ju fëmijë,  
Që të keni një ardhmëri  
Plot dituri e harmoni.

## **Babai im**

Babi im, për mua  
Ke shumë vlerë në këtë botë,  
Edhe pse je larg, ty s'të haroj,  
Çdo natë të kujtoj.  
Na ndau ky mërgim i zi,  
Por unë sërish të dua ty.  
Kam një shqetësim  
Dua të jetoj pranë babit tim,  
Dorën t'ia shtrëngoj, ta përqafoj,  
Dhe t'i them se sa shumë më mungon,  
Je pjesa e jetës sime,  
Dua të kthehesh, bashkë të jetojmë.  
Bashkë do të jemi  
Këto ditë do t'i kalojnë,  
Do të vijë dita që do të na bashkon,  
Ajo ditë neve do na gëzon,  
Dita kur ti do të kthehesh nga mërgimi,  
Do të përqafoj ty,  
Gjithmonë je në zemrën time,  
Në çdo ditë të kam në mendime.  
Babi im të dashuroj pa fund,  
Larg nesh je, po unë s'të haroj,  
Në zemrën time je gjithmonë,  
Vendin tënd askush se zëvendëson.  
Pa ty jeta ska kutim,  
Pa ty jetën nuk mundem as ta paramendoj,  
Eja ktheu nga ai mërgim,  
Mallin ta largoj, të çmallem me ty,  
Te shiojmë ditë me gëzime,  
Shumë festa e ditëlindje,  
Të dua pa fund baba, këtë mos e haro.

## **Bredhi im**

Për këtë Vit të Ri  
E kam stolisur bredhin  
Me shumë lodra,  
E llampione, për bukuri.

E lumtur jam,  
Që së bashku  
Me prindët e mi,  
Do ta festojmë Vitin e Ri.

Babagysh i Vitit të Ri  
Na sjell dhurat e lumturi,  
Me plot gjallëri, po e presim  
Këtë Vit të Ri



## **Dallëndyshe**

Dallëndyshe moj dallëndyshe,  
Me sqepin e vogël,  
Me bishtin si gërsherë,  
Çdo mëngjes me zërin  
E ëmbël, mua më zgjon.

Aq bukur me zë të ëmbël  
E të bukur këndon,  
Çdo fëmijë e gëzon,  
Je e vogël por shumë e mirë,  
Sepse çdo natyrë i jep bukuri.

## **Dimri**

Erdhi dimri,  
Fshatin tim e mbuloi  
Me çarçaf të bardhë e zbukuroi,  
Koha ndryshoi, acari filloi.  
Fëmijët luajnë me topa bore,  
E ndërtojnë njeri prej bore,  
Rëshqasin me saj e ski,  
Erdhi kjo stinë  
Ka edhe një festë  
Të bukur, Festa e Vitit të Ri,  
Që gëzon çdo femijë.  
Veshur trash, dorë për dore,  
Dalim luajnë me topa bore.  
Dimri është stinë e ftohtë,  
Me borë kjo stinë na erdhi,  
Vendin e mbuloi,  
Fjolla, fjolla bora filloi.

## **Ditëlindja**

**S**ot kam ditëlindjen

**I** ftoj gjithë miqët e mi

**H**amë ëmbëlsira

**A**në e mbanë zbukurime

**N**ë shtëpinë time plot gëzime

**A**të ditë kur nuk e haroj

## **Ditura**

Nëse ju keni dituri  
E njohuri, në jetë do te keni  
Plot lumturi,  
Me dituri e njohuri  
Mund të bëhesh  
Çka dëshiron ti.  
Mjek, aktor, profesor,  
Mëso, dituri fito,  
Një ardhmëri të mirë,  
Për vete siguro.

## **Dorë për dore**

Dorë për dore fëmijet  
Bëjnë kurore,

Dorë për dore fëmijet  
Shkojnë në ëmbëltore,

Dorë për dore fëmijet  
Luajnë me topa bore,

Dorë për dore fëmijet,  
Hanë akullore,

Dorë për dore fëmijët  
Shkojnë shkollë,

Dorë për dore fëmijet  
Dalin në obor.

## **E mira**

E mira të sjell lumturi,  
E mira të sjell dashuri,  
E mira të sjell ngrohtësi,  
E mira të sjell harmoni,  
E mira të sjell gëzim,  
E mira të sjell bukuri,  
E mira të sjell mirkuptim,  
E mira të sjell respekt,  
E mira të sjell nderim,  
E mira të sjell qetësi,  
E mira të sjell mirësi,  
Emira është gjithçka,  
Që të sjell të mira.

## **Edhe unë dëshiroj**

Edhe unë dëshiroj  
prej së afërmi yjet t'i shiqoj,  
Edhe unë dëshiroj  
të mësoj, dituri të fitoj,  
Edhe unë dëshiroj  
prindërit t'i gëzoj,  
Edhe unë dëshiroj  
lumturi dhe bashkësi,  
Edhe unë dëshiroj  
që ndarësia mos egzistoj,  
Edhe unë dëshiroj  
në mërgim të mos shkoj.

## **Familja**

Sa e dua, unë familjen time  
Ata kujdesen për mua  
Më ushqejnë, e më këshillojnë  
Në mësimime më ndihmojnë,  
Nuk harojnë të më këshillojnë,  
Në rrugë të drejtë më orientojnë,  
Dhe për jetë më udhëzojnë.



## **Festat e Nëntorit**

Festat e Nëntorit po afrohen,  
Shqiptarët, gjithandej po gëzohen,  
Dita e flamurit kuq e zi,  
Është më e bukura festë,  
Se sa një mijë flori.  
Ne jemi shqipe me dy krena,  
Gajku jonë rrjedh nëpër vena  
Për flamurin tonë.  
Skenderbeu ka luftuar,  
Me flamurin kuq e zi  
Të gjitha betetjat i ka fituar.

## **Gjuha jonë**

Gjuha jonë është  
Me shumë vlerë,  
Gjuhë tonë nuk e ndroj  
Me gjuhë tjetër, asnjëherë.

Gjuha jonë shqiptare  
Është një gjuhë ndërkombëtare  
Është një gjuhë e veçantë  
Ka vlerë po si diamante

## **Jetimit**

Jetimët duhet ndihmuar  
Ata janë të vetëm  
E të lënduar.

Jam e lumtur që kam,  
Prindërit e mi.  
Ata kujdesen për mua,  
Për mrekulli.

Jetimët janë të vetmuar  
Të trembur e të lënduar.

Për Jetimët ka ftohtësi,  
Po vjen dimri e ai,  
Do të jetoj, në borë e në shi.

## **Klasa ime**

Në klasën time  
Mësojmë mësimë,  
Arsimtarët na japin obligime  
E na tregojnë tregime.

Kur mësuesi na thotë;  
Javën tjetër do shkojmë  
Në eksuzion,  
Ne shumë gëzohemi  
Se në shëtitje do shkojmë.

Klasë, më e mirë jemi  
Nota të mira gjithmonë kemi,  
Mësojmë pa ndërprerë  
Që të parët në shkollë,  
Gjithmonë të jemi.

## **Ku lind dielli**

Ku lind dielli  
Ka ngrohtësi,  
Ku lind dielli  
Ka lumturi e harmoni.

Ku lind dielli  
Qeshet çdo fëmijë,  
Rrezet drejt nesh i drejton ,  
Çdo ditë lind një diell i plotë  
Dhe tokën e ndriçon.

## **Kursej**

Kursej kohën që mos shoj kot,  
Kursej ditën, në shkollë të shkoj,  
Kursej orë të mësoj,  
Kursej muaj, vepër të bëj,  
Kursej shkronjë poezi për të krijuar.

Në shkollë duhet të shkojmë,  
Dituri të fitojmë,  
Një ditë shkollën ta mbarojmë,  
Të kemi një ardhmëri,  
Me dituri, harmoni, e lumturi  
Me plot gjallëri.

## **Libri**

Libri është dritë e dituri,  
Shumë gjëra mësova nga ai,  
Mësova të shkruaj,  
Mësova të lexoj,  
Mësova shumë vjersha  
Të recitoj .

Nga libri mësova poezi të krijoj,  
Të dashurve të mi tua kushtoj,  
Me plot lumturi po mësoj,  
Librat çdo ditë i shfletoj.

Libri është rruga e jetës,  
Nuk ka gjë që ska libri,  
Prej librit marrim njohuri,  
Marrim dituri,  
Mësojmë se si jetën ta jetojmë,  
Mësojmë se si njerzit t'i respektojmë.

## **Luftë të mos ketë**

Luftë të mos ketë,  
Të ketë lumturi,  
Të ketë buzeqeshje, e dashuri.  
Të gjithë të jenë të lirë,  
Se liria është e çmuar,  
Këtë jetë duhet jetuar.  
Për jetë kemi shumë  
Për të mësuar,  
Të lumtur të jetojmë,  
Me ardhmëri,  
Sepse ardhmëria është e çmuar.



## **Lulet e kopshtit tim**

Lulet e kopshtit tim  
Kanë plot gjelbërim,  
Lulëzojnë, kopshtin e hieshojnë,  
Lule, lule plot me ngjyra,  
Kështu i shtohet bukuria.

I ujis me plot gëzim  
Ta zbukurojnë kopshtin tim,  
Të shkëlqejnë me lule behari  
Manushaqe, karanfila, trendafila  
E shumë lule të mira.

Çdo lule ka aromë  
Natyren e kopshtit tim e freskojnë,  
Edhe ato kanë shpirt  
Ato ritën me dritë e me uij,  
Nese nuk ka diell e uij  
Ato thahen dhe shëmtohen.

Asnjëher mos ua humbni  
Luleve bukurinë ,  
Asnjëher mos e shëmtoni  
Me dëshirë lulet ti zbukuroni .

## **Padrejtësia e mërgimit**

Mërgimtarët ditë e natë  
Punojnë, para të fitojnë,  
Shtëpinë e tyre ta gëzojnë.  
Babi im punon në mërgim  
Kur vjen në shtëpi  
Gëzohen gjithë familjarët e mi.  
Ah ky kurbet i zi  
Ka aq shumë padrejtësi,  
Sa që nuk ua din vlerën  
Punonjësive të rrijë.

## **Motra ime**

Kam një motër shumë të mirë,  
Në çdo gjë me jep këshillë,  
Në mësimë më ndihmon,  
Detyrat e shtëpisë m'i sqaron,  
Jam e lumtur e krenare  
Që kam një motër lozonjare.

Çdo shqetësim ia tregoj,  
Njëra tjetrën e ndihmojmë,  
Motra të mira jemi, nota të mira kemi,  
Çdo herë njëra tjetrës i qëndrojm pranë,  
Dhe kështu ia dalim mbanë.

Smundem larg teje të qëndroj,  
Zemra ty të kërkon,  
Dashurinë tënde askush se dhuron,  
Je e mirë, e bukur, lozonjare,  
Motër për ty jam shumë krenare.

Për mua je gjithçka,  
Ty nuk të zëvendëson askush,  
Vetëm ti më don pa kusht,  
Motër të nderoj dhe pa fund të dashuroj.

## **Mësueses sime**

Mësuesen time, shumë e dua  
Ke qenë nëna e dytë për mua,  
Më ke edukuar, e shumë gjëra  
Të mira, për jetë mi ke mësuar.

Mësuesja ime, ti do të ngelësh  
Gjithmonë në mendjen time,  
Katër vite bashkë kaluam  
Ty kurë s'kam për të të haruar.

## **Natyra**

Sa e bukur  
Është natyra,  
Lulet plot me ngjyra.

Fëmijët vrapojnë,  
Lule këpusin,  
Kurora ndërtojnë.

Natyra ka gjelbërim,  
Fëmijët luajnë,  
Në natyrë me gëzim.

## **Nëna ime**

Nëna ime sa shumë të dua,  
Dhe ti më don fortë mua,  
Ti je gjak në trupin tim,  
Ti je dritë në syt e mi,  
Ti je emri i mirësisë,  
Ti je yll i shtëpisë.

Me aromën tënde  
Mua më lumturon,  
Çdo dëshirë ma plotëson,  
Gjithmonë më lumturon,  
Dua të të them se pafund të dashuroj.

## **Pandemia**

Prej kur na erdhi kjo pandemi,  
Na solli vetëm fatkeqësi,  
Vdiqën shumë njerëz,  
Na mbyllën nëpër shtëpi.

Me mësim online  
Çdo kush ka vërshtirsi,  
Mësuesi në shkollë,  
Ne në shtëpi.  
Online nuk mundemi të mësojmë,  
Me pranin fizike në shkollë  
Dua të shkojmë e të mesojmë,

Çdo ditë numri po shtohet,  
Me sëmundjen e rëndë infektohet,  
Kovidi i preku pleq e të ri,  
Mbyllën restorane e pizeri,  
Nuk guxon të dël jashta,  
Pa maskë, as një njeri.

Maska, dizefektues, dorëza,  
Për mborjtje nga kjo pandemi,  
Jemi mërztitur me orë policore,  
Karantina, e mësimin online,  
E shumë teste për kovidin.

## **Pasuria dhe lumturia**

Aq sa na duhet pasuria,  
Po aq na duhet shëndeti,  
Dashuria dhe lumturia.  
Në familjen time  
Të ketë plot gëzime,  
Të ketë bashkësi  
Me motra e vëllezëri .  
Dikush ka pasuri  
E në familje  
Nuk ka lumturi,  
Nuk bënë mirësi  
Ajo është padrejtësi.  
Me pasuri nuk mund të blesh  
shndet, dashuri dhe lumturi.



## **Poeteshë**

Dua të jem poeteshë  
Të shkruaj prozë e poezi,  
Të bëj vepra për çdo njeri.

Të shkruaj prralla e tregime,  
Të shpreh dashurinë time,  
Poetesh do të jem,  
Veprat e mia do i kem.

Çdo kush t'i lexoj,  
Shumë gjëra nga librat ,  
Të mësojnë, e të kuptojnë.

## **Sdo ta haroj**

Sdo ta haroj,  
Kur hypa në gurë,  
Horizontin tej shiqova  
Dëshirën plotësova.

Sdo ta haroj,  
Kur nga një urë,  
Vështroja lumin e kristaltë,  
Ëndërën plotësova.

Sdo ta haroj,  
Nën një lis qëndroja,  
Vargjet në flete rreshtoja  
Realitet jetën e bëja.

## **Sbëj dallim**

Sbëj dallim në shtëpi,  
Sbëj dallim ne shoqëri,  
Sbëj dallim në prindërit e mi,  
Sbëj dallim në motart e mia,  
Sbëj dallim në vëllezrit e mi,  
Çdo kënd e dua një lloj,  
Askënd nuk do e ofendoj.

## **Shkolla**

Ne në shkollë shkojmë  
Të mësojmë, të respektojmë  
Dituri të fitojmë.

Nëse ne mësojmë,  
Prindrit tonë i gëzojmë,  
Të gjithë të lumtur jetojmë.

Shkolla ime  
Je si dielli,  
Je si nëna,  
Je si yll,  
Shkolla ime  
Je gëzimi,  
I jetës sime.

## Shpresa

Shpresa është gjithçka,  
Me shpresë babain nga mërgimi e pres,  
Me shpresë veper dua të bëj,  
Me shpresë dua të këndoj,  
Me shpresë dua poezi të krijoj,  
Me shpresë të dashurve të mi t'ua kushtoj,  
Me shpresë bëj gjithçka,  
Me shpresë lexoj,  
Me shpresë mësoj,  
Me shpresë që një ditë shkollën do e mbaroj,  
Me shpresë që një ardhmëri,  
Për vete do ta siguroj,  
Me shpresë vjersha recitoj,  
Asnjëher mos e humbni shpresën,  
Me shpresë arrin qëllimin  
Plotson çdo ëndërr  
Ëndrrimi të sjell shumë gëzim.

## **Shtatori i hidhëruar**

Me një shtator  
Të gjithë shkonim në shkollë,  
Shokë e shoqe mësonim,  
Arsimtarin e dëgjonim.

Shkolla është në vetmi,  
Nëpër banka ska fëmijë,  
Kishim ditë me gëzime,  
Nuk kishim hidhërimë.

Njëri tjetrin e ndimonim,  
Çdo herë detyrat i bënim,  
Ra kjo pandemi,  
Jemi mbyllur nëpër shtëpi.

## **Shtëpia ime**

Në shtëpin time unë jetoj,  
Fëmijërinë aty e kaloj,  
Mësimet i mësoj, detyrat i bëj,  
Në punët e shtëpisë,  
Nënë e ndihmoj.

Në shtëpin time,  
Ka plot gëzime,  
Kur kemi ditëlindje,  
Bëjmë shumë zbukurime.

Kjo është shtëpia ime,  
Me shumë gëzime,  
Me lumturi, ngrohtësi dhe harmoni .

## Stinët

Dy të nxehta,  
Dy të ftohta,  
Janë të mira,  
Por të vështira.

Stina e parë, pranvera,  
Ikën por si era.

Pastaj vjen vera,  
Çelin lule tjera.

Vjeshta vjen,  
Koha ndryshon,  
I ftohti po afron.

Erdhi dimri,  
Gjithë çka dimëron,  
Me jorgan të bardhë  
Vendin mbulon.



## **Tërmeti**

Ra ky tërmet në Izmir,  
I shembi ndërtesa e shtëpi.  
Ndruan jetë shumë të ritur e fëmijë.

U ndodhi kjo tragjedi,  
Pa prind kanë mbetur shumë,  
Fëmijë ndjejnë ftohtësi ,  
Skanë shtëpi e ku të strehohen,  
Gjithë po frigohen.

## **Vëllau im**

Fjala vëlla  
Fjalë e shtrejtë,  
Kush ka një vëlla  
Botën e plot e ka.

Çdo herë të ndihmon,  
Çdo herë gjej mbështetje,  
Në çdo krizë më këshilla,  
Në ditë të vështira më lehtëson,  
Çdo gjë më tregon.

Vëllau është gjithçka,  
Vëllaut i tregon çdo problem,  
Fjala vëlla me katër shkronja  
Çdo problem e zgjedh  
Çdo herë të gëzon  
Vëlla ma i bukri emër.

## Zogjtë shtegtar

Erdhi pranvera  
I kthei zogjtë por si era,  
Folenë e tyre filluan ta ndërtojnë,  
Me zogjët e vegjël ditet e nxeta,  
Aty do të qëndrojnë.

Aq bukur e aq mirë këndojnë,  
Në ballkon cicërimat fillojnë,  
Foleja e tyre shkëlqen si yll,  
Lartë në qiell vizëllon e ndriçon.

Sa mirë i ushqen nëna zogjt e saj,  
I ngroh si një diell, lartë në qell,  
Dimri i acart i largon zogjt shtegtar,  
Por ato vendin e tyre se harojnë.

## 28 Nëntori

Dita e pavarsisë  
Të flamurti të shqiptarisë,  
Çdo shqiptar e feston  
Veshur kuq e zi,  
Po këndojmë për Nënë Shqipëri.

Trimat shqiptar ngritën  
Flamurin kombëtar.  
Do këndojmë do vallëzojmë  
28 Nëntorin ta festojmë.  
Me familje e shoqëri,  
Të shkruajmë vargje  
Për Nënë Shqipëri.

Flamurit tonë e qëndisi  
E madhja Marigonë.  
Po shpreh dashuri,  
Për flamurin tonë kuq e zi,  
Se nuk e harojmë atëdheun tonë.

Çdo vit shqiptaria feston  
Ditën kombëtare të atëdheut tonë.  
Ju uroj festën e 28 Nëntorit  
Me plot lumturi e dashuri.  
Kombi jonë i veçant,  
E ka vlerën si diamat.

## Përmbajtja

Atdheu.....	4
Bibloteka.....	5
Babai im.....	6
Bredhi im.....	7
Dallëndyshe.....	8
Dimri.....	9
Ditëlindja.....	10
Ditura.....	11
Dorë për dore.....	12
E mira.....	13
Edhe unë dëshiroj.....	14
Familja.....	15
Festat e Nëntorit.....	16
Gjuha jonë.....	17
Jetimit.....	18
Klasa ime.....	19
Ku lind dielli.....	20
Kursej.....	21
Libri.....	22
Luftë të mos ketë.....	23
Lulet e kopshtit tim.....	24
Padrejtësia e mërgimit.....	25
Motra ime.....	26
Mësueses sime.....	27

Natyra.....	28
Nëna ime .....	29
Pandemia.....	30
Pasuria dhe lumturia.....	31
Poeteshë .....	32
Sdo ta haroj .....	33
Sbëj dallim .....	34
Shkolla .....	35
Shpresa.....	36
Shtatori i hidhëruar.....	37
Shtëpia ime.....	38
Stinët .....	39
Tërmeti .....	40
Vëllau im.....	41
Zogjtë shtegtar.....	42
28 Nëntori .....	43



Sihana Nexhbija është nxënëse në Shkollën  
fillore komunale “Fan Noli” të f. Pallaticë.

Vjersha e parë e sajë “Familja ” i është postuar  
te faqa e shkollës si nxënëse e klasës së gjashtë.

Është vepra e parë e saj . Është nxënëse e sjellshme,  
meer pjesë në aktivitete shkollore.

Bashkëjeton me familjen në f. Pallaticë.